



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2021:013470

Datë: 10.06.2021

Numri i dokumentit: 01879655

**PKR.nr.08/21**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ – DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA**, me Kryetarin e trupit gjykues Sahit Krasniqi dhe me Sekretaren juridike Adelina Sallahu, në çështjen penale kundër të akuzuarit A.Z., për shkak veprës penale përdorimi i armës apo i mjetit të rrezikshëm nga neni 367 par.1 të KPRK-, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj, PP/I. nr. 15/21 të dt. 27.01.2021, pas mbajtjes së shqyrtimit publik për pranimin e marrëveshjes për pranimin e fajësisë, në praninë e Prokurorit të Shtetit Sebahate Sinani, të akuzuarit A.Z. dhe mbrojtëses së tij av. Kushtrim Obrazhda, me datë 10.06.2021 mori dhe publikisht komunikoi këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I akuzuari A.Z.**, nga babai N.... dhe nena S...., mbiemri i vajzërisë së nënës M...., i lindur me date .... në Prishtinë, me vendbanim në rr.” ....” Ferizaj, ka të kryer Fakultetin e Shkencave të Kriminologjisë, punon si Zdrukthtar, i gjendjes së mesme ekonomike, i martuar, babë i tre fëmijëve, me numër personal ....., me numër telefoni ....., mbrohet në liri.

**ËSHTË FAJTOR**

- **Sepse:** në muajin Nëntor të vitit 2019, nën orët e mbrëmjes në Ferizaj, në rr. “...”, i pandehuri ka përdorur armë markës “HS” modeli 9x19, me numër serik ....., të cilën e ka poseduar me leje, në atë mënyrë që me të njëjtën shtie tri here me qëllim të largimit të disa geneve nga oborri i shtëpisë së tij të cilët rrezikonin fëmijët e tij të mitur, me çraste si pasojë këtyre të shtënave është dëmtuar roleta e dritares së shtëpisë së të dëmtuarit R.F. si dhe janë shkaktuar dy vrima në murin e shtëpisë, ndërsa me dt. 11.07.2020, arma e lartshënuar dhe 47 cope fishekë të kalibrit 9m, i gjenden dhe i sekuestrohen nga ana e policisë .

**- Me te cilën ka kryer veprën penale përdorimi i armës apo i mjetit te rrezikshëm nga neni 367 par.1 te KPRK-.**

**Në bazë të dispozitës së sipërcituar dhe neneve 4, 7, 17, 21, 38, 39, 46, 47, 48, 49, 69, 70, 71, 72 të KPRK-së si dhe nenit 233 dhe 365 të KPPK-së të akuzuarit i ,**

## **SH Q I P T O N**

### **DENIM ME KUSHT**

**Dënim burgimi në kohëzgjatje prej 6/gjashte/muajve, i cili nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri në periudhën kohore prej 1/një/viti nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk kryen vepër tjetër penale.**

**Ne bazë të nenit 367 par.3 te KPRK-se, konfiskohet në mënyrë të përhershme arma markës “HS” modeli 9x19, me numër serik H228534, dhe 47 cope fishekë te kalibrit 9mm.**

I dëmtuari R.F. per realizimin e kërkesës pasuroro juridike udhëzohet ne kontest te rregullt civil.

**Obligohet** i akuzuari që në emër të paushallit gjyqësor të paguajë shumën prej 30 (tridhjetë) Euro, si dhe të paguaj shumën prej 50/pesëdhjetë/euro në Fondin për kompensimin e viktimave të dhunës, të gjitha këto në afat prej 15/pesëmbëdhjetë/ditëve, nga data kur aktgjykimi të merr formën e prerë, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

## **A r s y e t i m i**

### **1. Historiku procedural**

Prokuroria Themelore në Ferizaj-Departamenti për Krime te Renda me aktakuzën të evidentuar si PP/I. nr. 15/21 të dt. 27.01.2021, ka akuzuar të akuzuarin A.Z. nga Ferizaj, për veprën penale përdorimi i armës apo i mjetit te rrezikshëm nga neni 367 par.1 te KPRK-.

Prokurori i Shtetit aktakuzës së paraqitur i ka bashkangjitur edhe marrëveshjen për pranimin e fajësisë për te akuzuarit A.Z. e datës 27.01.2021, deklarata e të akuzuarit te njëjtën datë, te nënshkruara nga i akuzuari dhe, mbrojtësi i tij av. Kushtrim Obrazhda, prokurorit së shtetit Sebahate Sinani dhe kryeprokurori i Prokurorisë Themelore në Ferizaj Shukri Jashari.

Kryetari i trupit gjykues duke vepruar sipas kësaj aktakuze ka mbajtur seancën e shqyrtimit të marrëveshjes me datë 10.06.2021 në të cilën i akuzuari, mbrojtësi i tij dhe prokurori i shtetit u deklaruan përkitazi me marrëveshjen e pranimit të fajësisë dhe duke i propozuar Gjykatës pranimin e saj sipas kushteve të përcaktuara.

## **2. Vlerësimi i marrëveshjes së pranimit të fajësisë**

Gjatë shqyrtimit të marrëveshjes për pranimin e fajësisë, Gjykata konstatoj se janë plotësuar të gjitha kërkesat e përcaktuara me dispozitën e nenit 233 par. 18 të KPP-ës:

- i akuzuari A.Z. ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë;
- pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga i pandehuri pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësin e tij av.Kushterim Obrazhda.

- pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që përmban akuza dhe në materialet e prezantuara nga prokurori dhe atë dy vërtetimet mbi sekuestrimin e sendeve të dt. 11.07.2020, zinxhiri i ruajtjes, raporti i këqyrjes së vendit të ngjarjes, raporti i oficerit të dt. 10.11.2019 dhe fotografitë të cilat gjenden në shkresat e lëndës, të gjitha këto prova të siguruara gjatë procedurës hetimore;

- si dhe nuk ekzistojnë asnjë nga rrethanat e parapara me nenin 253 par.1 dhe 2 të KPP-së.

Andaj, gjykata pranoi marrëveshjen për pranimin e fajësisë dhe bazuar në këto marrëveshje vazhdoi me shqiptimin e dënimit.

## **3. Vlerësimi ligjor**

Duke vlerësuar në aspektin juridik Gjykata gjeti se në veprimet e të akuzuarit A.Z. ekzistojnë të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale përdorimi i armës apo i mjetit të rrezikshëm nga neni 367 par.1 të KPRK-.

## **4. Vlerësimi për dënimin e shqiptuar.**

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit për të akuzuarin, Gjykata vlerësoj se i akuzuari A.Z. ka arritur marrëveshje për pranimin e fajësisë dhe përmes dënimit të shqiptuar “Dënimin me Kushte” do të arrihet qëllimi i përcaktuar me nenin 38 të KPRK-ës përkatësisht dënimi i shqiptuar është plotësisht i justifikueshëm, në përshatje me rrethanat e kryerjes se

veprave penale, rrezikshmërinë shoqërore të këtyre veprave, që do të shërbej në parandalimin e kryesve nga kryerja e këtyre veprave penale në të ardhmen (preventiva speciale) si dhe do të arrihet qëllimi që ti përmbaj personat e tjerë nga kryerja e veprës penale (preventiva gjenerale).

Konform nenit 463 par.2 te KPRK-se, i dëmtuari R.F. për realizimin e kërkesës pasuroro juridike është udhëzuar ne kontest te rregullt civil.

Konform neneve 450 dhe 453 të KPPK-ës, obligohet i pandehuri që në emër të paushallit gjyqësor të paguajë shumen prej 30 (tridhjetë) Euro, si dhe shumen prej 50/pesëdhjetë/euro në emer te Fondin për kompensimin e viktimave të dhunës, të gjitha këto në afat prej 15/pesëmbëdhjetë/ditëve, nga data kur aktgjykimi të merr formën e prerë, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

Nga arsyet e sipër cekura është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ -DEPARTAMENTI PËR KRIME TË  
RËNDA, PKR.nr.08/21 me 10.06.2021**

**Sek. Juridike**  
**Adelina Sallahu**

**Kryetari i trupit gjykues,**  
**Sahit Krasniqi**

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 15 ditëve, pas pranimit të kopjes me shkrim të këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë. Ankesa i dorëzohet Gjykatës Themelore në Ferizaj.